



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 07.06.2016

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I
HIDROCENTRALIT “SHPELLA POSHTË 2”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt kërkues “Liria Energji” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Hidrocentralit “Shpella Poshtë 2”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Shpellës, degë e lumit Shkumbin, fshati Shpellë Zall, qarku Korçë”, me subjekt kërkues shoqërinë koncesionare “Liria Energji” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



A circular blue ink stamp from the Ministry of Urban Development in Tirane, Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE - AGJENCIA E ZHVILLIMIT URBAN - TIRANE" and features the national coat of arms of Albania in the center. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



A circular blue ink stamp from the Agency for Urban Development in Tirane, Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - TIRANE" and features the national coat of arms of Albania in the center. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.